

PROCESVERBAL
nga seanca e 1-rë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 4.1.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 1-rë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 41-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 25.12.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 10-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 25.12.2023.
3. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 42-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 25.12.2023.
4. Propozim - aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Institucionit të Arsimit të Lartë Privat Universiteti i Shkupit - Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP.

5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Softuer - sistemi i regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, ofruet të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe ofruet të shërbimeve, platforma për shkëmbimin e videove.
6. Propozim për dhënie miratimi për zbatimin e procedurës për furnizim publik: Shërbim nga agjenci private për punësim.
7. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 41-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 25.12.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 10-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 25.12.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 42-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 25.12.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 4

Z. Trajçeovski shpjegoi Propozim - aktvendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Institucionit të arsimit të lartë privat Universiteti i Shkupit - Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP. Ai shpjegoi se pika është e natyrës administrative sepse rrjedh si pasojë e Vendimit për heqjen e lejes për transmetuesin në fjalë. Në pajtim me Ligjin, për t'u fshirë nga regjistri i transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia, Këshilli duhet të marrë Aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Institucionit të arsimit të lartë privat Universiteti i Shkupit - Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Institucionit të Arsimit të Lartë Privat, Universiteti i Shkupit - Shkup, Institucioni radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta boton në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 5

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Softuer – sistemin për regjistrin elektronik të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe ofruesit e shërbimeve, platforma për shkëmbimin e videove. Ai shpjegoi se pa platformat për shkëmbimin e videove, ky softuer ishte një modul softuerik i përpiluar (punuar) nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike diku në vitet 2013-2014 duke përdorur serverët e AKE. Vitin e kaluar marrëveshja për mirëmbajtjen e softuerit përfundoi dhe kompania që deri më tani e mirëmbante nuk dëshironte që edhe më tej të vazhdonte marrëveshjen sepse tani ky softuer është tashmë një model i vjetëruar teknologjikisht. Por ata thanë se nëse paraqiten probleme teknike deri në furnizimin dhe punimin e softuerit të ri, do ta përballojnë atë dhe rekomanduan që të sigurohet softuer i ri. Ndërkohë janë bërë ndryshime në LSHMAAV ku ASHMA ka kompetenca shtesë dhe për këtë arsye propozohet që të përmirësohet softueri i mëparshëm, që duhet të bëhet(përpilohet) nga operatori ekonomik që do të fiton (marrë) furnizimin publik.

Z. Petrushevski tha se i kishte parë specifikimet teknike dhe deklaroi se do ta mbështesë propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik: Softuer – sistemin për regjistrin elektronik të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe ofruesit e shërbimeve, platforma për shkëmbimin e videove.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-mallrat: Sistemi softuerik për regjistrin elektronik të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe ofruesit e shërbimeve, platforma për shkëmbimin e videove, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizime publike për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

Pika 6

Z. Petrushevski, në lidhje me Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik: Shërbim nga agjenci private për punësim, tha se ky furnizim është shumë i rëndësishëm për punën e Agjencisë, posaçërisht që këtë vit do të mbahen zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare.

Z. Trajçevski sqaroi se furnizimi vijues publik për këtë shërbim përfundon në ditët e para të prillit 2024. Por duke qenë se shpallen zgjedhjet dhe do të formohet qeveria teknike diku më 28 janar të këtij viti dhe muajin e ardhshëm në shkurt pritet të shpallen dy procese zgjedhore, presidenciale dhe parlamentare, për të mos ardhur në situatë ku marrëveshja e vjetër përfundon dhe për të mos mundur të angazhohen bashkëpunëtorë, kjo procedurë fillon menjëherë (tani) me kërkesë të Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik. Marrëveshja e re do të zbatohet pas skadimit të atij vijues, pra me kusht që nëse skadon i vjetri, menjëherë do të fillojë zbatimi i marrëveshjes së re në përputhje me këtë furnizim publik. Ai ka theksuar se një pjesë e këtyre mjeteve do të plotësohen nga buxheti.

Z. Petrushevski tha se mund të ketë ndryshime në Kodin Zgjedhor dhe është mirë që ky furnizim publik të jetë gati. Ai theksoi se do të mbështesë furnizimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik: Shërbim nga agjenci private për punësim.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Shërbim nga agjenci private për punësim është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 7

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI